

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8316
E martë, 9 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Mavraj voton për strategjet e lirisë në Hagë

IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTIT I BIE FUQIA E VOTËS NGA 51.1 PËR QIND NË 42.91 PËR QIND

IFAQE 4-5



Lëvizja Vetëvendosje i fitoi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit në Kosovë, por me rezultat më të dobët në krahasim me zgjedhjet paraprake të dhjetorit. Partia e Albin Kurtit mori 42.91 për

qind të votave, sipas rezultateve preliminare të KQZ-së. E dyta doli Partia Demokratike e Kosovës me 21.13 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.58 për qind, dhe Aleanca me 7.16 për

qind të votave. Në këtë përqindje nuk janë përfshirë votat me kusht dhe ato të diasporës. Në zgjedhje dolën gati 37 për qind e qytetarëve me të drejtë vote, më pak se në votimet e dhjetorit

AKTUALE



IRANI NJOFTON PËR NDALJE TË SULMEVE NDAJ IZRAELIT F. 2

IKD: TË GJITHA GJOBAT E KPM-së PËR SHKELJET E MEDIEVE JANË TË KUNDËRLIGJSHME F. 3

NIS NUMËRIMI I VOTAVE PËR DEPUTETË F. 4

EKONOMI



MILIONA EURO TË PAPAGUARA PËR PENSIONET E MINATORËVE TË "TREPÇËS" F. 8

SPORT



KOSOVA RIKTHEHET TE FITORJA, TRIUMFI NDAJ ANDORRËS IU DEDIKUA FATJON BUNJAKUT F. 11



BE-ja: ZGJEDHJET NË KOSOVË HAPIN RRUGËN PËR TEJKALIMIN E BLOKADËS POLITIKE F. 8

KE: PROJEKTI NË ZVËRNEC MUND TË NDIKOJË NË RRUGËN E SHQIPËRISË DREJT BE-së F. 8



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

IRANI NJOFTON PËR NDALJE TË SULMEVE NDAJ IZRAELIT

TEHRAN, 8 QERSHOR - Komanda qendrore e ushtrisë së Iranit njoftoi për ndaljen e sulmeve ajrore kundër Izraelit, duke deklaruar se i ka dhënë "një përgjigje të dhimbshme" Izraelit lidhur me sulmet izraelite në qarkun Dahijeh të Bejrutit, por paralajmëroi se çdo vazhdim i agresionit izraelit do të prodhojë hakmarrje "edhe më intensive dhe shkatërruese".

Njoftimi i 8 qershorit erdhi pak kohë pasi presidenti amerikan Donald Trump shkroi në "Truth Social" se "të dyja palët, Izraeli dhe Irani, po synojnë të arrijnë një armëpushim të menjëhershëm", duke shtuar se negociatat përfundimtare për një marrëveshje paqeje ShBA-Iran po vazhdojnë dhe se bllokada amerikane ndaj porteve iraniane do të mbetet në fuqi deri në arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare. Në deklaratën e tij, Shtabi Qendror i Khatam Al-Anbiya në vetvete nuk shpalli një armëpushim, por një operacion të përfunduar, me disa kushte. Ai e paraqiti ndaljen e luftimeve jo si ulje të tensioneve, por si një

mesazh të dërguar, në përpjekje për të ruajtur imazhin e forcës, ndërkohë që po synon uljen e përshkallëzimit të cilin e sinjalizoi Uashingtoni.

Ky është pikërisht ai operacion që analistët e kishin përshkruar edhe gjatë kohës kur sulmet po kryheshin. Irani kishte vendosur një kërcënim specifik në tryezë: nëse sulmohej Dahijehi, ku ndodhet baza e aleatit libanez të Iranit, atëherë Irani do ta godiste veriu e Izraelit. Kur Izraeli goditi periferitë e Bejrutit, Teherani kishte pak zgjedhje përveçse ta shndërronte kërcënimin në vepër, ose ta humbiste besueshmërinë e çdo kërcënimi të ardhshëm që bën. "Ky veprim kishte të bënte kryesisht me ruajtjen e besueshmërisë të një kërcënimi që Irani e kishte bërë publik më herët", tha për Radion Farda të Radios Evropë e Lirë, Mohammad Ghaedi, ligjërues në Universitetin "George Washington". "Përgjigjet janë të kufizuara dhe asnjëra nga palët nuk dëshiron që kjo të çojë në një luftë në shkallë të plotë". Mehrdad Khansari, analist me



bazë në Londër dhe ish-diplomat iranian, ngjashëm e sheh këtë situatë.

Llogaritja e Teheranit, sipas tij, mbështetet në një lexim të caktuar të kufizimeve të Uashingtonit – se Shtetet e Bashkuara, që përballen me Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, mbylljen e Ngushticës së Hormuzit dhe me një ekonomi të tronditur globale – do të ushtronin presion ndaj Izraelit që përgjigje e tij të ishte e kufizuar. "Irani po demonstroi kapacitetin e tij", tha Khansari. "Mesazhi është: unë po qëndroj i

palëkundur, po i mbroj aleatët e mi dhe nuk do t'ju lejoj të shfrytëzoni atë që ju e perceptoni si dobësi".

Deklarata e lëshuar nga Irani ndjekë këtë logjikë.

Ajo është e dizajnuar që të duket si vetëpërmbajtje, teksa njëkohësisht e rrit tavanin e deklaruar për rëndin e ardhshëm – fraza "shumë më intensive dhe shkatërruese se më parë" siguron që tërheqja e sotme të mos lexohet si dorëzim. Ajo që ka arritur Irani, nëse ky pushim në luftime qëndron, është një kthim në gjendjen e

mëparshme, me pozicionin e tij të parandalimit, që e ruan në mënyrë nominale. Ai ka përmbushur një zotim publik, ka përballuar çfarëdo reagimi izraelit që mund të vijë dhe është tërhequr përpara se përshkallëzimi të shndërrohej në diçka që asnjëra palë nuk mund ta kontrollojë.

Pyetja tani është nëse Izraeli do të pranojë të njëjtën rrugëdalje. Postimi i Trumpit në Truth Social sugjeroi se të dyja palët po lëviznin drejt një armëpushimi të menjëhershëm, por zyrtarët izraelitë, gjatë këtij konflikti, në disa raste kanë vepruar në mënyrë të pavarur nga kërkesat e Uashingtonit.

Në një intervistë për Financial Times, Trump tha më 7 qershor se kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu, "nuk do të ketë asnjë zgjedhje tjetër" përveçse të pranojë çdo marrëveshje që Shtetet e Bashkuara arrijnë me Iranin. "Unë i marr vendimet. Unë i marr të gjitha vendimet. Ai nuk i merr vendimet", tha Trump, pavarësisht se Izraeli kreu sulme ndaj Iranit në orët e para të 8 qershorit.

KOMISIONI EVROPIAN THOTË SE RITJJA E NUMRIT TË RUSËVE ME SHTETËSI SERBE PËRBËN RREZIK POTENCIAL SIGURIE PËR BE-NË

BRUKSEL, 8 QERSHOR - Megjithëse politika e shtetësisë është kompetencë e Serbisë, numri në rritje i shtetasve rusë që, përmes marrjes së shtetësisë serbe, fitojnë mundësinë e hyrjes pa viza në Bashkimin Evropian (BE), përbën sfidë të mundshme sigurie për bllokun, vlerësoi Komisioni Evropian (KE).

Në dokumentin më të fundit të Komisionit Evropian, i cili vlerëson progresin e Serbisë në kapitujt 23 dhe 24 që lidhen me sundimin e ligjit, thuhet se gjatë periudhës së fundit është rritur numri i shtetësive të dhëna për shtetasit rusë. "Pavarësisht të drejtës sovraane të Serbisë për të vendosur mbi politikën e saj të shtetësisë dhe natyralizimit, fitimi i përsheptuar i së drejtës për udhëtim pa viza në BE nga shtetasit rusë përmes dhënies së shtetësisë serbe, numri i të cilëve është rritur krahasuar me vitet e mëparshme, paraqet rreziqe të mundshme sigurie për BE-në", thuhet në dokumentin joformal të KE-së, të cilin e ka parë Radio Evropa e Lirë (REL).

Ky dokument ishte çështje diskutimi në nivelin e diplomatëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në fund të

majit. "Serbia duhet ta përmirësojë kontrollin e kërkesave për viza të paraqitura nga shtetas të vendeve që konsiderohen me rrezik në aspektin e migracionit të parregullt ose të sigurisë", thuhet më tej.

Kohët e fundit, disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian po ushtrojnë trysni mbi Komisionin Evropian për ta propozuar një ligj që do ta lehtësonte refuzimin e vizave turistike për shtetasit rusë, për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Moska.

Sipas të dhënave të BE-së, numri i vizave turistike të lëshuara për zonën Shengen për shtetasit rusë u rrit gjatë vitit 2025 në pothuajse 480.000, që është niveli më i lartë që nga fillimi i pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka njoftuar tashmë se Serbia nuk do të vendosë viza për shtetasit rusë.

Sipas kushteve të Planit të Rritjes, Serbia deri në fund të vitit duhet të vendosë viza për të paktën tri shtete.

Politika e vizave e Serbisë është "vetëm pjesërisht e



harmonizuar" me politikën e vizave të Bashkimit Evropian dhe me listën e vendeve të treta, qytetarët e të cilave kanë nevojë për vizë për të hyrë në BE, thuhet në raportin për sundimin e ligjit për Serbinë.

Aktualisht, 12 të ashtuquajtura vende të treta gëzojnë regjim pa viza me Serbinë, por jo edhe me BE-në: Armenia, Azerbajxhani, Bahrejni, Bjellorusia, Kina, Indonezia, Xhamajka, Kirgizi, Kazakistani, Rusia, Surinami dhe Turqia. "Nuk është arritur përparim i mëtijshëm në harmonizimin me politikën e

vizave të BE-së që nga dhjetori i vitit 2024, kur Serbia përmbushi detyrimet e saj nga Agjenda e Reformave për harmonizimin e regjimit të vizave me BE-në për të paktën tri vende, shtetasit e të cilave kanë nevojë për vizë për të hyrë në BE", thuhet në dokument.

Me Agjendën e Reformave, Serbia është zotuar të vendosë regjim vizash për të paktën tri nga shtetet e përmendura. Vlera e këtij detyrimi në kuadër të Planit të Rritjes është pak më shumë se 27 milionë euro. Mosrealizimi i këtij detyrimi deri

në fund të vitit 2026 do të rezultonte në humbjen e kësaj shume të mjeteve financiare.

Në Agjendën e saj të Reformave për Planin e Rritjes, Serbia kishte parashikuar zbatimin e këtij detyrimi deri në fund të dhjetorit 2024.

Megjithatë, Komisioni Evropian u ka miratuar të gjitha vendeve të rajonit një periudhë shtesë, të ashtuquajtur "grace period".

Për detyrimet që duhej të përmbusheshin deri në fund të vitit 2024, afati është zgjatuar me 24 muaj, pra deri në dhjetor të vitit 2026.

Ndërkohë, para se të vendosë eventualisht viza për të paktën tri shtete, Komisioni Evropian kërkon nga Serbia që të ashpërsojë rregullat për lëshimin e vizave për shtetasit e vendeve që ende kanë regjim pa viza me Serbinë, por jo me BE-në.

Komisioni konsideron se në këtë mënyrë do të sigurohej kontroll më i madh dhe harmonizim më i mirë me standardet e BE-së, si dhe do të zvogëlohej fluksi i migrantëve të parregullt drejt Bashkimit Evropian nga shtetas të vendeve të treta që hyjnë në Serbi me viza të vlefshme.

Osmani: Emri im nuk do të bëhet pengesë për krijimin e institucioneve

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Ish-presidentja Vjosa Osmani i ka falënderuar qytetarët e Kosovës, mbështetësit dhe votuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për besimin e dhënë në zgjedhjet e fundit, duke theksuar se angazhimi i saj do të mbetet i fokusuar në tejkalimin e krizës politike dhe ndërtimin e institucioneve.

Në "Facebook", Osmani ka thënë se gjatë muajve të fundit ka takuar mijëra qytetarë në gjithë Kosovën dhe se shpresa e tyre për një vend më të zhvilluar dhe më të bashkuar ka qenë motivimi kryesor. "Dëgjuam shqetësimet tuaja,

ëndrrat tuaja dhe shpresën tuaj për një vend më të zhvilluar, më të integruar dhe më të bashkuar. Kjo shpresë ishte forca jonë më e madhe", ka theksuar ajo.

Duke folur për rolin e saj pas zgjedhjeve, Osmani ka ritheksuar se nuk do të jetë pengesë për formimin e institucioneve të reja. "Në këtë drejtim, e ritheksoj atë që e kam thënë disa herë: emri im as nuk ka qenë, as nuk është e as nuk do të bëhet pengesë në krijimin e institucioneve", theksoi Osmani. Sipas saj, kontributi i saj do të jetë i përqendruar në tejkalimin e krizës politike dhe



funksionalizimin e institucioneve. "Përkundrazi, i gjithë kontributi im do të jetë i fokusuar vetëm në daljen nga kriza dhe ndërtimin e institucioneve të cilat mbrojnë

shtetin, demokracinë, Kushtetutën dhe aleancat", ka deklaruar Osmani.

Në fund të mesazhit të saj, ajo ka theksuar se angazhimi për Kosovën do të vazhdojë. "Ky rezultat nuk është fundi i një gare. Është vazhdimi i një misioni. Rruga vazhdon. Bashkë", ka përfunduar Osmani.

Pas publikimit të rezultateve preliminare, Osmani në një konferencë të përbashkët për medie me Lumir Abdixhikun u shpreh se Lëvizja Vetëvendosje nuk ka arsye ta refuzojë kandidaturën e saj për një mandat tjetër në pozitën e presidentes së Kosovës.

BE-ja: ZGJEDHJET NË KOSOVË HAPIN RRUGËN PËR TEJKALIMIN E BLOKADËS POLITIKE

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Kaja Kallas, tha se zgjedhjet demokratike dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë krijojnë mundësinë për t'i dhënë fund më shumë se një viti bllokade politike. Sipas saj, tani u takon liderëve politikë të veprojnë në mënyrë konstruktive për ta siguruar funksionalizimin e institucioneve. "Zgjedhjet demokratike dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë hapin rrugën për ta kthyer faqen pas më shumë se një viti ngërçi politik. Liderët politikë tani duhet të angazhohen në mënyrë konstruktive për ta siguruar formimin e shpejtë të qeverisë", shkroi Kallas në platformën X.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë u mbajtën më 7 qershor me një pjesëmarrje prej rreth 35 % të trupës elektorale.

Rezultatet preliminare, të publikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, e nxorën partinë e kryeministrit në



detyrë, Albin Kurti, Lëvizjen Vetëvendosje, të parën - me 42.91 % të votave.

Pas saj renditen: Partia Demokratike e Kosovës me 21.08 %, Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.60 %, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me

7.17 % dhe Lista Serbe me 6.17 %.

Pas shpalljes së fitores, Kurti e la të hapur mundësinë për bisedime dhe bashkëpunime me partitë e tjera.

Kallas theksoi, gjithashtu, se përparimi në dialogun Kosovë -

Serbi dhe normalizimi i marrëdhënieve mes dy vendeve mbetet thelbësor për avancimin e Kosovës në rrugën evropiane. Edhe komisionarja për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, uroi kryetarën e Lëvizjes Vetëvendosje, Kurti, për fitoren në zgjedhje, duke

theksuar njëkohësisht nevojën për bashkëpunim mes forcave politike. "Që Kosova të ecë përpara në rrugën e saj drejt BE-së, forcat politike tani duhet të bashkohen dhe të gjejnë kompromis për të ndërtuar stabilitet institucional", shkroi Kos në platformën X. Ajo shtoi se mezi pret ta vizitojë Kosovën për ta shtuar punën rreth integritimit evropian dhe vazhdimin e mbështetjes përmes Planit të Rritjes të BE-së.

Zgjedhjet e 7 qershorit u mbajtën pas dështimit të Kuvendit të Kosovës për ta zgjedhur presidentin e ri - çfarë çoi automatikisht në shpërndarjen e institucionit ligjvënës. Ato ishin zgjedhjet e treta brenda më pak se një viti e gjysmë pas zgjedhjeve të rregullta të 9 shkurtit 2025 dhe një tjetër palë zgjedhesh të parakohshme më 28 dhjetor.

Zgjedhjet e para nuk arritën të prodhojnë qeveri, ndërsa të dytat, ndonëse i siguruan Lëvizjes Vetëvendosje mbi 51 % të votave, nuk sollën marrëveshje për zgjedhjen e presidentit, sipas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

IKD: Të gjitha gjobat e KPM-së për shkeljet e medieve janë të kundërligjshme

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) organizoi konferencë për medie në të cilën publikoi raportin "Kur rregullatori shkel rregullat: Kundërligjshmëria e gjobave të KPM-së ndaj shkeljeve të medieve". Sipas një njoftimi për medie, thuhet se Musliu paraqiti gjobat e shqiptuara nga ana e KPM-së ndaj medieve që nga funksionalizimi i këtij institucioni.

Mes të tjerash, ai theksoi se të njëjtat kanë të bëjnë kryesisht me shkeljet e medieve përgjatë fushatave zgjedhore

të proceseve zgjedhore të vitit 2025 dhe zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit 2026. "Arsyet se pse janë të kundërligjshme të gjitha këto vendime, u elaboruan nga Shala. Ky i fundit vendimet e KPM i ndau në dy grupe. Për vendimet lidhur me shkeljet e pretenduara gjatë zgjedhjeve të vitit 2025, Shala tha se janë të kundërligjshme pasi janë marrë shumë kohë pas afateve të përcaktuara nga Rregullorja KPM-2024/03", thuhet në njoftim.

Më tutje, siç thuhet në njoftim, derisa të gjitha

vendimet, përfshirë fushatat zgjedhore nga viti i kaluar dhe këtë të fundit për zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit 2026, Shala theksoi se janë nxjerrë në një procedurë ku rol të rëndësishëm ka pasur Zyra Ekzekutive e KPM-së, e cila, sipas tyre, është drejtuar për vite nga një ushtrues detyre i kryeshefit ekzekutiv përtej afateve të lejuara me ligj. "Kurse Miftaraj tha se situata me KPM-në sa iu përket gjobave të kundërligjshme është pasojë e dështimit institucional. Ai përmendi në radhë të parë



Kuvendin e Kosovës, duke theksuar se nuk e ka mbajtur KPM-në me kuorum. Derisa shtoi se përgjegjësia bie edhe mbi KPM-në, e cila nuk e ka

zgjedhur kryeshefin ekzekutiv të Zyrës Ekzekutive të KPM-së, por këtë pozitë po e mban me ushtrues detyre", thuhet në njoftim.



KURTIT I BIE FUQIA E VOTËS NGA 51.1 PËR QIND NË 42.91 PËR QIND

Lëvizja Vetëvendosje i fitoi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit në Kosovë, por me rezultat më të dobët në krahasim me zgjedhjet paraprake të dhjetorit. Partia e Albin Kurtit mori 42.91 për qind të votave sipas rezultateve preliminare të KQZ-së. E dyta doli Partia Demokratike e Kosovës me 21.13 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.58 për qind dhe Aleanca me 7.16 për qind të votave. Në këtë përqindje nuk janë përfshirë votat me kusht dhe ato të diasporës. Në zgjedhje dolën gati 37 për qind e qytetarëve me të drejtë vote, më pak se në votimet e dhjetorit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Rezultatet preliminare të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit në Kosovë kanë krijuar paradoks të njohur: numrat sugjerojnë mundësi për formimin e institucioneve, por realiteti politik paralajmëron një tjetër ngërç të mundshëm.

Rreth 2 milionë qytetarë të Kosovës kishin të drejtë vote në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit të cilat u organizuan pas dështimit të Kuvendit për zgjedhjen e presidentit, por pjesëmarrja ishte vetëm rreth 35 %.

Zgjedhjet u zhvilluan pa incidente që do të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit. Më shumë se 900 kandidatë nga 17 parti politike dhe tri koalicione garuan për ulëse në Kuvendin e Kosovës i cili ka gjithsej 120 deputetë.

Më shumë se 900 kandidatë nga 17 parti politike dhe tri koalicione garuan për ulëse në Kuvendin e Kosovës i cili ka

gjithsej 120 deputetë.

Sipas të dhënave preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ka dalë e para me 42.91 % të votave, e ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 21.13 %, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 17.58 %, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 7.16 % dhe Lista Serbe me 6.18 %. Në këtë përqindje nuk janë përfshirë votat me kusht dhe ato të diasporës.

Ndarja e mandatave pritet të jetë kështu: LV-ja 48 deputetë, PDK-ja 24, LDK-ja 20, AAK-ja 8, pakicat serbe 10 dhe pakicat joserbe 10.

Në zgjedhjet e dhjetorit, bazuar në rezultatet përfundimtare, Lëvizja Vetëvendosje (LV) kishte fituar 51.1 për qind të votave, PDK-ja 20.1 për qind, LDK-ja 13.24, kurse Aleanca 5.50 për qind.

Pas shpalljes së rezultateve, lideri i kësaj partie, Albin Kurti, paralajmëroi se do të komunikojë me të gjitha subjektet politike, duke theksuar

nevojën për bashkëpunim në funksion të "interesit publik dhe vullnetit të përgjithshëm". "Pra, llogarisni te ne, jo vetëm në punën që bëjmë, por edhe në bashkëpunimin që do të bëjmë", tha Kurti para mbështetësve të tij.

Ai ka thënë se për dhjetë ditë të fushatës kanë mbajtur mijëra aktivitete, tubime e takime cep më cep të Republikës sonë. "Dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët që na pritën krahëhapur dhe pa asnjë hezitim e me të cilët ndamë përvojat dhe nevojat që kanë për të ecur edhe më shumë përpara. Ndonëse numërimi i votave ende nuk është përfunduar, unë falënderoj secilin votues, në Kosovë e mërgatë, që përmes zgjedhjeve demokratike, doli për të votuar dhe shprehu vullnetin e tij përmes votës. Vazhdojmë të punojmë, krejt për shtet, sepse pa dyshim kemi shtet për krejt", ka thënë Kurti.

Sekretarja e përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë se PDK po e rikonfirmon pozicionin e saj


përfaqësuese përkundër që gara zgjedhore ka qenë e pabarabartë.

Çitaku në një konferencë për medie tha se pushteti i deritashëm i ka lodhur qytetarët me kriza të njëpasnjëshme dhe mospjesëmarrja e qytetarëve "është mesazh politik që duhet të merret seriozisht, sidomos nga ky pushtet abuziv". "Qeverisja e Kurtit prodhoi zhgënjim të madh qytetar, prodhoi kriza të vazhdueshme. Kjo keqeverisje rezultoi me këtë protestë zgjedhore, sepse mosdalja e rreth 200 mijë votuesve tregon zhgënjim të jashtëzakonshëm qytetar. Gara ishte e pabarabartë dhe sikur mos të bënte blerje masive të votave me qindra miliona euro, me premtime për punësim, kërcënime ndaj punonjësve shtetërorë, me milionë euro për bileta për diasporën dhe keqpërdorim të resurseve shtetërore, ky do të pësonte fiasco politike. Përkundër kësaj gare të pabarabartë, me blerje masive të votave përmes ndihmave, PDK-ja po e rikonfirmon pozicionin e saj përfaqësues, me përqindje dhe me numër të deputetëve", shtoi ajo.

Ajo bëri me dije se PDK-ja e pret numërimin e plotë të votave për t'i bërë publike qëndrimet e saj, duke bërë thirrje që çdo votë të numërohet me kujdes, të ruhet me integritet. "Ne e presim rezultatit përfundimtar. E presim numërimin e plotë të votave. Dhe, më pas, do t'i bëjmë publike qëndrimet tona. Juve si medie ju falënderojmë për raportimin korrekt. Po ashtu, në

emër të Partisë Demokratike të Kosovës i falënderoj të gjithë ata që morën pjesë në këtë proces zgjedhor. Por, i falënderojmë KQZ-në, komisionarët, vëzhguesit, mediet dhe Policinë e Kosovës për angazhimin e tyre në mbarëvajtjen e tij. Tani është thelbësore që çdo votë të numërohet me kujdes, të ruhet me integritet dhe të respektohet vullneti i qytetarëve", shtoi ajo. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka falënderuar votuesit, aktivistët dhe qytetarët për mbështetjen e dhënë në zgjedhjet e 7 qershorit, ku kjo parti mori 17.58 për qind, duke e cilësuar rezultatit si një dëshmi të rikthimit të besimit ndaj LDK-së. "Qytetarëve të Kosovës - mirënjohje për vlerësimin e dhënë dhe për mundësinë e dytë ndaj nesh. Nga dhjetori deri më sot nuk ka kaluar shumë kohë. Në çdo normalitet kohor, gjërat nuk do të ndryshonin kaq shpejt. As gjashtë muaj diferencë mes dy palë zgjedhjeve. Por për LDK-në, dhe vetëm LDK-në e askënd tjetër, ishte ndryshe. Këtë herë për të mbarë. Nga një krizë historike me apetite e projeksione të errëta, drejt një stabiliteti të ri. Drejt rikthimit të besimit duke qenë të vërtetë dhe duke qenë vetja. Dhe kjo është pasuria më e madhe që kemi sot. Qëndrojmë si LDK me 20 mandate. Veprimtarëve tanë të palodhur - ju faleminderit! Ju jeni arsyeja e këtij rikthimi, prandaj kokën lart. Ju zotohem se nuk do të lejojmë që mundi juaj të shpërdorohet më nga asnjë protagonizëm individual. LDK-ja juaj është në rrugën e

MAVRAJ VOTON PËR STRATEGËT E LIRISË NË HAGË



Prishtinë, 8 qershor- Publicisti dhe profesori universitar Muhamet Mavraj ka ushtruar të drejtën e tij të votës në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të Kosovës më 7 qershor.

Përmes një postimi në "Facebook", Mavraj theksoi se vota është shenja kryesore e qytetarisë dhe ftoi të gjithë qytetarët të votojnë.

Ai kritikoi edhe fenomenin e shitjes së votës, duke thënë se ata që e shesin votën për përfitime të momentit, në fund mbeten peng i atyre që e blejnë atë.

Mavraj bëri me dije se vota e tij ishte e orientuar drejt kandidatëve që, sipas tij, kanë mbështetur vazhdimisht strategjet e lirisë që po përballen me procesin gjyqësor në Hagë, si dhe familjarët dhe dëshmitarët e tyre. "Miq, përsëri në votime, herët-herët, sepse vota është shenja kryesore e qytetarisë. Prandaj, të votojmë të gjithë dhe secili. Sundimtarët e këqij zgjidhen nga qytetarët e mirë që nuk votojnë, ka thënë i mençuri. Dhe nga këta që po e shesin votën. Këtyre u them se paratë do t'i shpenzojnë deri në mbrëmje, por pastaj blerësi do t'i shes tërë jetën, si skllevër. Fokusi i votës sime ishte brenda natyrës sime, për ata që nuk pushuan kurrë angazhimin për strategjet e lirisë në Hagë, për ndonjë të afërm të tyre apo dëshmitar të sinqertë në gjyq. Me këto votime ndahen ujerat përfundimisht: ose me perëndimin amerikan ose u bëmë gazi i botës. Votojmë qetë dhe njohim rezultatit shpejt e pa poterë. Nuk jemi dorëzuar as

në kohë më të vështira! Mbesim optimistë të pathyeshëm!", ka shkruar Mavraj.

Mavraj: 30 vjet sot i bën flamuri amerikan në Kosovë. Do të duhej të ishte festë, por nuk ka kush ta bëjë. Ata që do ta bënin janë në Hagë

"Para tre vitesh ua përshkrova zemrën dhe shpresën pas ngritjes së këtij flamuri.

Mirënjohja është karakter, jo dobësi. Do të duhej të ishte festë sot. Nuk ka kush ta bëjë. Ata që do ta bënin janë në Hagë. Le të bëhet feste pasnesër nga vetë qytetarët. Ose kthehemi me vepra konkrete me SHBA-të ose u bëmë gazi i botës. Te mos harrojmë: në vorbullat e reja të botës as vetë amerikanët nuk po



ecin mbarë pa aleatët e mëdhenj, e lerë më kombi ynë pa amerikanët.

Miq, ky është viti i fundit për këndellje!", ka shkruar Mavraj në rrjetin sociale në "Facebook" më 5 qershor.



drejtë. Bashkimi sapo ka nisur, dhe siç ju kemi thënë, ky bashkim nuk do të ndalet. Do ta vazhdojmë angazhimin tonë gjithandë Kosovës. Që nga sot madje. Ka ende shumë njerëz që presin ftesën tonë, shumë energji të mira e të reja që duan të bëhen pjesë e këtij rrugëtimit", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka thënë se përpara kanë edhe reforma të thella të brendshme. "Na duhen njerëz që i japin vizionit tonë, që ndërtojnë bashkë me ne, e jo të tillë që vetëm marrin pa dhënë, pengojnë e shpresojnë në rrënim kolektiv për përfitim individual. Këto reforma do t'i bëjmë. Me prioritet, shpejt dhe qartë si kurrë më parë. Por përtej vetes sonë, tani është koha t'i japim vendit drejtim. Kosova jonë vazhdon të jetë në krizë. Kosova jonë ka nevojë për stabilitet. LDK për të dytën herë arriti të krijojë parakushte për balancë demokratike para kontrollit absolut. Nuk ishte e lehtë. Pa punën tonë Kosova do të dukej e frikshme. Tani na duhet maturi, vizion dhe apetit për zhvillim të vendit. Prandaj, një rrugë e gjatë na pret përpara. Dhe këtë rrugë do ta ecim bashkë", ka shkruar ai.

Abdixhiku i ka uruar të gjitha partitë politike në Kosovë për një garë demokratike dhe për rezultatit zgjedhor. "Le ta shfrytëzojmë këtë rezultat për ta bërë vendin siç e meriton. Falënderoj, po ashtu, të gjithë ata që na uruan, inkurajuan e ofruan veten për drejtimin përpara. Ishit të shumtë, ishin me zemër, ishin me plot dashni - sepse kjo shtëpi vërtet është e juaja", ka thënë ai. Zgjedhjet e 7 qershorit ishin të tretat parlamentare që Kosova mbajti në 16 muaj. Në tri palë zgjedhje, fituesja ishte LV-ja.

LV-ja me rënie në përqindje në të gjitha komunat, LDK-ja dhe AAK-ja me rritje, PDK-ja mbetet stabile

Eugen Cakolli nga KDI ka publikuar një analizë krahasuese të rezultateve preliminare të zgjedhjeve të fundit me ato të 28 dhjetorit 2025, duke theksuar ndryshime të dukshme në përqindjet e subjekteve politike në nivel komunal. Sipas tij, përveç dallimeve në numrin e përgjithshëm të votave si pasojë

Nis numërimi i votave për deputetë

Pas ditës së zgjedhjeve, në 38 qendra komunale të numërimit do të zhvillohet procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë. Paraprakisht do të bëhet verifikimi i rezultateve të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime.

Verifikimi dhe numërimi ka filluar paraditen e së hënës, në QKN-të e 15 komunave: Laposaviq, Novobërdë, Obiliq, Shtime, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Junik, Mamushë, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranillug, Partesh, Klokot, Mitrovicë e Veriut.

e daljes më të ulët në zgjedhje, të dhënat tregojnë lëvizje interesante në nivel komunash. "Përveç dallimeve në numrin e përgjithshëm të votave, që normalisht reflektojnë daljen dukshëm më të ulët në zgjedhjet e djeshme, rezultatet në nivel komune tregojnë edhe disa

Ndërkaq, në orën 16:00, po të ditës së hënës, aktivitetet kanë filluar në QKN-të e 23 komunave: Deçan, Gjakovë, Gllgoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë. Për fillimin e verifikimit/numërimit në të gjitha komunat dhe për të njoftuar për aktivitetet e KQZ-së pas ditës së zgjedhjeve, do të mbahet konferencë për medie në orën 16:30, në QKN "1 Tetori" në Prishtinë.

lëvizje interesante në përqindjet e subjekteve politike. Nëse krahasohen rezultatet preliminare të zgjedhjeve të djeshme me ato të 28 dhjetorit 2025, sipas tabelës së mëposhtme, dalin disa gjetje interesante: - LV-ja ka pësuar rënie në përqindje në secilën

prej 38 komunave të Kosovës. Ndonëse mbetet partia e parë në shumicën e tyre (31 sosh), rënia është e evidente - duke humbur edhe primatin në tri komuna. Rënie më të theksuara, LV i ka në Suharekë (-14.54 pikë përqindje), Mamushë (-14.07), Junik (-10.30) dhe Rahovec (-10.23). - LDK-ja ka shënuar rritje në përqindje në 35 komuna. Rritjet më të mëdha, LDK i ka në Istog (+10.6 pikë përqindje), Malishevë (+9.2), Junik (+8.6), Suharekë (+8.2) dhe Rahovec (+7.7). - PDK-ja duket më stabile, dhe për dallim nga partitë e tjera, lëvizjet në shumicën e komunave i ka relativisht të vogla. PDK-ja ka shënuar rënie në 21 komuna, ndërsa në 16 të tjera ka shënuar rritje. PDK-ja ka shënuar rritjen më të madhe në komunën e Malishevës me rreth 22 pikë përqindje - që është lëvizja më e madhe komunale e evidentuar në këto zgjedhje. AAK-ja ka rritur përqindjen e votave në 30 komuna, ndonëse në shumicën prej tyre në përqindje simbolike. Rritjet më të mëdha, AAK i ka shënuar në Suharekë (+9.2 pikë përqindje), Deçan (+7.6), Rahovec (+6.5), Junik (+6.2) dhe Gjakovë (+4.5)", ka shkruar Cakolli.

Revista "Kosova Anthropologica" avancon në ruajtjen ndërkombëtare digjitale të përmbajtjes shkencore

PRISHTINË, 8 QERSHOR - "Kosova Anthropologica" është konfiguruar plotësisht në DOAJ për ta filluar ruajtjen afatgjatë të përmbajtjes së saj përmes CLOCKSS në kuadër të iniciativës ndërkombëtare JASPER.

Ky është një hap i rëndësishëm për forcimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe

dukshmërisë ndërkombëtare të botimeve shkencore të Universitetit të Prishtinës. Ruajtja digjitale nëpërmjet CLOCKSS siguron që artikujt dhe përmbajtja shkencore e revistës të arkivohen në mënyrë të sigurt dhe të mbeten të qasshme për studiuesit, studentët dhe publikun edhe në të ardhmen. "Ky zhvillim e afron më tej

Kosova Anthropologica me standardet ndërkombëtare të botimit me qasje të hapur (Diamond Open Access) dhe përforcon përkushtimin e Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e botimeve akademike cilësore, të qëndrueshme dhe të integruara në infrastrukturën globale të dijes", tha kryeredaktori i revistës, prof. Arsim Canolli.

Universiteti i Prishtinës falënderon DOAJ-in dhe JASPER-in për mbështetjen në këtë proces si dhe ekipin editorial të "Kosova Anthropologica" për punën e vazhdueshme në ngritjen e standardeve të revistës. "Kosova Anthropologica" që nga themelimi është përfshirë në rrjete të shumta evropiane dhe botërore të revistave me qasje të

KOSOVA ANTHROPOLOGICA

hapur, duke rritur praninë ndërkombëtare dhe rrjetëzimin.

DEPARTAMENTI EVROPIAN I FMN-së VLERËSON BQK-në

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Në një intervistë për RTK-në, të realizuar në kuadër të Konferencës Rajonale të nivelit të lartë të organizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me temën "Kornizat e politikave dhe rregullimit në një mjedis në ndryshim", zëvendës-drejtori i Departamentit Evropian të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Mark Horton, ka vlerësuar lart përparimin e Kosovës dhe reformat e ndërmarra nga BQK-ja gjatë viteve të fundit.

Duke folur për zhvillimet në Kosovë, Hortoni e cilësoi vendin historik suksesi dhe partner i rëndësishëm i FMN-së. Ai ka theksuar se vitet e fundit kanë qenë një periudhë intensive modernizimi dhe transformimi për BQK-në, duke prekur pothuajse çdo segment të funksionimit të saj. Po ashtu, ai ka vlerësuar përparimin në forcimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit financiar, zhvillimin e sistemeve moderne të pagesave, rritjen e përfshirjes financiare dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale.

Një vlerësim të veçantë ai ua kushtoi reformave të brendshme organizative të BQK-së, duke



përmendur modernizimin e qeverisjes institucionale, avancimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, reformimin e proceseve të rekrutimit, zhvillimin e politikave për mbështetjen dhe avancimin profesional të stafit si dhe forcimin e kapaciteteve analitike dhe profesionale. Sipas Hortonit, këto reforma përfaqësojnë një transformim të gjerë institucional që e ka bërë BQK-në më moderne, më efektive dhe më të përgatitur për sfidat e ardhshme.

Ai ka shprehur hapur admirimin për ritmin dhe përmasën e ndryshimeve të realizuara, duke theksuar se FMN-ja ka qenë dëshmitare e një përpjekjeje mbresëlënëse reformuese. Horton ka vlerësuar edhe lidhshirësinë e BQK-së për vizionin, vendosmërinë dhe proaktivitetin në zbatimin e një agjende ambicioze reformash, e cila ka prekur funksionet kryesore të bankës qendrore dhe organizimin e saj të brendshëm. Ai ka theksuar se bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet FMN-së dhe

BQK-së përmes asistencës teknike ka dhënë rezultate konkrete, pasi Kosova është ndër vendet që jo vetëm pranon rekomandimet profesionale, por i zbaton ato me efikasitet. Në vlerësimin e tij, reformat e ndërmarra nga BQK-ja gjatë viteve të fundit kanë kontribuar ndjeshëm në forcimin e stabilitetit financiar të Kosovës, në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit financiar dhe në përgatitjen e vendit për standardet dhe aspiratat e integritetit evropian.

Konferenca rajonale dyditore mbledhi në Prishtinë përfaqësues të lartë të FMN-së, bankave qendrore dhe institucioneve financiare nga rajoni dhe më gjerë. Ndër pjesëmarrësit kryesorë ishin Tobias Adrian, kryekëshilltar financiar dhe drejtor i Departamentit të Tregjeve Monetare dhe Kapitalit në FMN, si dhe Yigit Yaşar, drejtor ekzekutiv dhe anëtar i Bordit Ekzekutiv të FMN-së, së bashku me bashkëpunëtorët e tyre.

Tobias Adrian, kryekëshilltar financiar dhe drejtor i Departamentit të Tregjeve Monetare dhe Kapitalit në FMN, ka vlerësuar lart rolin e BQK-së si dhe stabilitetin dhe sofistikimin e sektorit financiar në Kosovë, duke u shprehur i impresionuar me dinamizmin ekonomik të vendit, energjinë e qytetarëve dhe cilësinë e politikave ekonomike dhe financiare. Ai më pas vlerësoi konferencën e organizuar nga BQK-ja, duke theksuar se temat e diskutuara si tokenizimi, inteligjenca artificiale, para digitalizimit dhe kryptoasetet pasqyrojnë debatet globale dhe janë thelbësore për adresimin e sfidave dhe mundësive që sjell transformimi i financave.

ZËVENDËSKRYESUESJA E KGJK-së MORI PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ENCJ-SË NË PARIS



PARIS, 8 QERSHOR - Zëvendëskryesuesja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Arjeta Sadiku, mori pjesë në Asambelën e Përgjithshme të Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë (ENCJ), e cila u mbajt në Paris, Francë. Në këtë ngjarje morën pjesë përfaqësues të këshillave gjyqësorë dhe institucioneve të drejtësisë nga vende të ndryshme evropiane, ku u

diskutua për fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit, avancimin e sundimit të ligjit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel evropian. Po ashtu, u miratua Deklarata e Parisit 2026 mbi "Besimin në sistemin gjyqësor". Punimet e Asamblesë u zhvilluan në ambientet historike të Gjykatës së Kasacionit në Paris, ndërsa pjesëmarrësit patën

mundësinë të trajtojnë tema që lidhen me sfidat dhe prioritetet e sistemeve gjyqësore në Evropë.

Pjesëmarrja e KGJK-së në këtë asamble konfirmon përkushtimin e vazhdueshëm të institucionit për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në funksion të avancimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Kosovës.

Dogana e Kosovës zbulon municion të padeklaruar në bagazhin e një udhëtari në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Dogana e Kosovës gjatë kontrolleve rutinë të udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, në fluturimin Hamburg - Prishtinë, ka ndaluar për kontroll një udhëtar i cili kishte kaluar

nëpër kanalën e gjelbër. Gjatë skanimit të bagazhit të tij, zyrtari doganor ka identifikuar elemente të dyshimta që mund të përbënin mall të ndaluar. Si rezultat është kryer kontroll fizik i valixhes, ku janë gjetur

11 copë fisheke për armë. Menjëherë pas konstatimit të rastit është njoftuar Policia e Kosovës në Aeroportin e Prishtinës, e cila ka ndërmarrë veprimet e mëtejshme ligjore dhe ka konfiskuar municionin e gjetur.

Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve, duke parandaluar hyrjen e paligjshme të mallrave të ndaluara në territorin e Republikës së Kosovës.



KE: PROJEKTI NË ZVËRNEC MUND TË NDIKOJË NË RRUGËN E SHQIPËRISË DREJT BE-së

TI RANË, 8 QERSHOR - Komisioni Evropian ka shprehur shqetësimin se projekti i planifikuar në zonën e mbrojtur Pishë Poro-Nartë mund të ketë ndikime mjedisore që bien në kundërshtim me procesin e negociatave të anëtarësimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Ditët e fundit në Shqipëri janë mbajtur protesta kundër punimeve për ndërtimin e një resori në Zvërnec, pranë Vlorës, mes shqetësimeve lidhur me ndikimin në mjedis dhe mosmarrëveshjeve mbi pronësinë e tokës. Zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier, ka tërhequr vëmendjen se, në procesin e anëtarësimit në BE, si pjesë e standardeve përmblylëse për negociimin e Kapitullit 27 mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike, Shqipëria pritet të përshtatet plotësisht me legjislacionin e bllokut evropian në këtë fushë. Kjo, sipas tij, përfshin zbatimin e Direktivave për Shpendët dhe Habitatet, shfuqizimin e dispozitave të papajtuësive të miratuara përmes ndryshimeve në Ligjin për zonat e mbrojtura, si dhe përfundimin e legjislacionit të vitit 2015 për investimet strategjike. "Përveç kësaj, për të mbyllur Kapitullin 27, Shqipëria duhet të tregojë kapacitetin e saj për të menaxhuar vendet e ardhshme të Natura 2000 [v.j. rrjet për zonat e mbrojtura natyrore në BE], duke përfshirë masat e ruajtjes që parandalojnë përkeqësimin e habitateve dhe specieve. Shqipëria duhet të përmbahet nga veprimet që mund të dëmtojnë përmbushjen

e standardeve të mbylljes", thuhet në përgjigjen me shkrim të zëdhënësit Mercier për Radion Evropa e Lirë (REL).

Kapitulli 27 i negociatave të anëtarësimit me BE-në përfshin mjedisin dhe klimën. Ai promovon zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Ky kapitull bazohet në veprime parandaluese, parimin "ndotësi paguan", luftimin e dëmeve mjedisore në burim, përgjegjësinë e përbashkët dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së.

Kapitulli 27 përfshin më shumë se 200 akte të rëndësishme ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rreziqeve, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht, zhurmën, pylltarinë si dhe ndryshimet klimatike.

Shqipëria ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian dhe renditet e dyta në mesin e vendeve kandidatë për sa i përket përparimit drejt anëtarësimit.

Shtetet anëtare të BE-së miratuan në muajin maj raportin për Vlerësimin e Përmbushjes së Kriterëve të Përkohshme në fushën e sundimit të ligjit, një hap i domosdoshëm për të avancuar drejt mbylljes së përkohshme të kapitujve negociues.

Megjithatë, zyrtarët evropianë pohojnë se shqetësimet e



shprehura nuk janë të reja. "Siç është theksuar tashmë në raportin tonë të fundit për zgjerimin, zgjatja e përsëritur e ligjit për investimet strategjike vazhdon të ngrejë shqetësime lidhur me ndikimet e mundshme mjedisore, veçanërisht në zonat e mbrojtura", tha zëdhënësi i Komisionit Evropian.

Ky zyrtar konfirmoi, gjithashtu, se shqetësime të ngjashme janë shprehur edhe pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë lidhur me mangësitë e mundshme të projektit. Sipas Mercier, ministria u ka bërë me dije bashkëbiseduesve evropianë se punimet e ndërtimit janë pezulluar dhe se për projektin do të kryhet një Vlerësim i Plotë i Ndikimit në Mjedis në konsultim me

shoqërinë civile.

Ndërkaq Agjencia për Media dhe Informim, pranë qeverisë shqiptare, ka konfirmuar se për këtë çështje më 26 maj gjatë një takimi online me përfaqësues të KE-së, ministri shqiptar i Mjedisit, Sofjan Jaupaj, informoi se nuk ekziston një projekt përfundimtar i miratuar dhe nuk ka asnjë projekt në ndërtim. "Ministri theksoi angazhimin e Shqipërisë për të garantuar se çdo projekt i mundshëm zhvillimi i nënshtrohet një vlerësimi të plotë të ndikimit në mjedis, të zhvilluar në transparencë të plotë dhe në konsultim me publikun. Shqipëria mbetet e angazhuar ndaj procesit të anëtarësimit në BE", tha Qeveria shqiptare.

Ndërkaq kryeministri shqiptar Edi Rama të dielën në mbrëmje

tha se debatet dhe shqetësimet e ngritura për projektet në Zvërnec dhe Sazan janë të "stisura" dhe "të pabazuara". Ai tha se nisma të tilla janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe do të shndërrohen në "shembuj krenarie kombëtare" duke ndihmuar, sipas tij, integrimin e Shqipërisë në BE. Zona e Pishë Poro-Nartës është një mjedis i mbrojtur dhe konsiderohet një nga habitatet më të rëndësishme në Shqipëri për zogjtë e ujit dhe ata shtegtarë, përfshirë flamingot. Punimet lidhen me planet e shpallura më herët nga Jared Kushner, dhëndri i presidentit amerikan Donald Trump. Në mars të vitit 2024, Kushner njoftoi se synon të ndërtojë hotele dhe qindra vila në zonën e Zvërnecit.

DELEGACIONI I MINISTRISË SË MBROJTJES ZHVILLON AKTIVITETE ZYRTARE NË VUKOVAR TË KROACISË

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Në kuadër të pjesëmarrjes në Konferencën ASDA 2026, delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes, i kryesuar nga zëvendësministri Gegë Lleshi, realizoi një vizitë edhe në qytetin e Vukovarit, me qëllim të njohjes nga afër me historinë e luftës dhe vendet përkujtimore që dëshmojnë sakrificën e popullit kroat në mbrojtje të lirisë dhe pavarësisë së vendit.

Delegacioni gjatë vizitës në Vukovar vizitoi Spitalin Memorial, Muzeun Përkujtimor dhe lokacione të tjera me rëndësi historike si dhe bëri homazhe në Varezat Memoriale të Viktimave të Luftës së Atdheut, duke vendosur lule në nderim të të rënëve.

Gjatë vizitës delegacioni u informua mbi zhvillimet historike të luftës në Vukovar, vuajtjet e popullatës civile dhe pasojat humanitare të konfliktit. Kjo vizitë shërbeu gjithashtu si moment reflektimi mbi përvojat e ngjashme të Republikës së Kosovës gjatë viteve 1998-1999. Në margjinat e aktiviteteve të

ASDA 2026, zëvendësministri i Mbrojtjes zhvilloi takime me veteranë të luftës së atdheut të Kroacisë, përfshirë edhe veteranë me prejardhje shqiptare që kontribuan në mbrojtjen e Kroacisë gjatë luftës. Me këtë rast u shpreh mirënjohje për kontributin dhe sakrificën e tyre në mbrojtje të vlerave të lirisë, demokracisë dhe paqes.

Po ashtu, delegacioni u takua me pesë kadetë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të cilët vijojnë studimet në institucionet edukative ushtarake të Republikës së Kroacisë. Gjatë takimit u diskutua për ecurinë e studimeve dhe zhvillimin profesional të tyre, duke vlerësuar përkushtimin e kadetëve në ngritjen e kapaciteteve të tyre akademike dhe ushtarake në shërbim të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Delegacioni, po ashtu, vizitoi edhe Ambasadën e Republikës së Kosovës në Zagreb, ku u prit nga ambasadori i Republikës së Kosovës, Martin Berishaj, dhe stafi diplomatik. Në takim u



diskutua për aktivitetet e ambasadës në avancimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë si dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm

ndërinstitucional në fusha me interes të përbashkët.

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit me vendet

partnere, zhvillimin e kapaciteteve profesionale të sektorit të mbrojtjes dhe promovimin e vlerave të përbashkëta të paqes, sigurisë dhe demokracisë.

MILIONA EURO TË PAPAGUARA PËR PENSIONET E MINATORËVE TË TREPÇËS

Punëtorë të kombinatit "Trepça" - ndërmarrje minerare në Kosovë - përballen me mospagesë të kontributeve pensionale tash e sa vite pavarësisht se ato u zbritën nga paga çdo muaj. Në disa raste në llogari figurojnë vetëm disa muaj të paguar brenda shumë viteve punë. Sindikata flet për shkelje ligjore dhe borxh prej miliona eurosh, ndërsa menaxhmenti i Trepçës pranon mospagesat që nga viti 2022, por nuk jep arsye apo afat për shlyerje të borxhit



Arben Hoti (RFE/RL)

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Në horizontet e errëta të Minierës së Stantërgut, ku zhurma e makinave përzihet me lodhjen e viteve, Fehmi Meha shtyn ngadalë një makinë të prishur. Këtë punë e ka bërë për më shumë se katër dekada. Por sot, përveç peshës së metalit, ai bart edhe një shqetësim që nuk lidhet me nëntokën: të ardhmen e tij pas pensionit. "Edhe një vit dal në pension... por nuk e di nëse do t'i marr kursimet e mia", thotë 64-vjeçari, i cili që nga viti 1983 punon si mjeshtër i makinave që transportojnë xehe në kombinatin e Trepçës. Ndërsa numëron muajt e fundit në punë, ai është i shqetësuar për mungesën e kontributeve pensionale që, siç thotë, nuk i janë paguar rregullisht nga punëdhënësi për më shumë se gjashtë vjet. "Janë mbi 5 mijë euro borxh. Nuk e di shumën e saktë, por e di që janë paratë e mia, të fituara me punë", thotë Meha për Radion Evropa e Lirë. Për të, situatën e rëndon edhe më shumë fakti se nga paga e tij prej rreth 720 eurosh në muaj, vazhdojnë t'i ndalen 5 për qind për kontribute pensionale, por ato nuk transferohen në Fondin e Kursimeve Pensionale - institucioni shtetëror që menaxhon kursimet pensionale të punëtorëve në Kosovë, i njohur si Trust. "Kjo është e padrejtë. Me duart tona i kemi fituar këto para", shprehet Meha.

Një problem sistematik

Sipas ligjit në Kosovë, çdo i punësuar paguan 10 për qind kontribute pensionale - gjysma paguhet nga punëdhënësi dhe gjysma nga paga e punëtorit. Këto mjete grumbullohen nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe transferohen në llogaritë individuale në Trust. Por, të dhënat tregojnë një realitet tjetër për disa punëtorë të Trepçës. Një pasqyrë e llogarisë së një punonjësi në Trust, e siguruar nga Radio Evropa e Lirë, tregon se nga viti 2020 deri në maj të këtij viti - gjithsej 77 muaj - kontributet janë paguar vetëm për 25 muaj. Pagesat janë përqendruar kryesisht në vitet 2022 dhe 2023, ndërsa në vitin 2021, 2025 dhe gjatë këtij viti mungojnë. Ky problem nuk është i izoluar. Sabri Ismaili, me 44 vjet përvojë pune në Trepçë si kryepunëtor, përballat me të njëjtin shqetësim. "Pensioni prej rreth 200 eurosh nuk mjafton as për shpenzime bazike. Më mungojnë mjetet nga Trusti... pa ato para nuk e di se si do t'ia dal", thotë Ismaili, gati 65 vjeç, për Radion Evropa e Lirë. Kjo situatë është "jonjerëzore" sipas tij, sidomos në një kohë kur, siç thotë, ndërmarrja raporton rritje të prodhimit dhe të fitimit. Kombinati Trepça, dikur shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe një ndër ndërmarrjet më të mëdha industriale në ish-

Jugosllavi, sot operon me kapacitete dhe staf të reduktuar ndjeshëm.

Deri në vitet '90, në të punonin mbi 22 mijë njerëz. Sot, në minierat e Mitrovicës, Kishnicës, Stantërgut e Artanës, numri i punëtorëve ka rënë në rreth 1.040.

Megjithëse të shpërndarë në disa njësi, minatorët ndajnë të njëjtat shqetësime.

Shemsi Avdyli, 44 vjeç, ndihmësxehtar në Artanë, thotë se në Trust ka të regjistruar vetëm disa muaj kontribute.

E njëjta situatë paraqitet edhe për kolegun e tij, Tahir Gashi.

Ai tregon se në llogarinë e tij në Trust figurojnë pagesat vetëm për tre muaj të vitit 2021. "Kjo është djersa jonë. Nuk e kam besuar kurrë se mund të ndodhë kjo në Trepçë. Punojmë me pajisje të vjetruara, në kushte të vështira dhe paratë tona na ndalen... është tmerr", thotë Gashi.

Sindikata: Shkelje ligjore dhe diskriminim

Gani Osmani nga Sindikata e Pavarur e Minatorëve thotë se kjo çështje është ngritur vazhdimisht te menaxhmenti dhe qeveritë, por pa rezultat konkret. Sipas tij, borxhi për secilin punëtor varion nga 6 000 deri në 10 000 euro. "Në vend që minatorët të jenë më të respektuarit, kanë mbetur më të diskriminuarit. Mospagesa në Trustit është shkelje ligjore",

thotë Osmani për Radion Evropa e Lirë. Ai shton se ka raste kur disa minatorë kanë dalë në pension - madje edhe kanë ndërruar jetë - pa i marrë këto mjete.

Pasojat pas pensionimit

Për Islam Kurtin, 68 vjeç, kjo nuk është më frikë, por realitet. Ai është pensionuar para tre vjetësh nga Miniera e Stantërgut dhe thotë se në Trust i mungojnë rreth 6.000 euro. Sot merr rreth 200 euro nga Trusti dhe 214 euro pension nga skemat shtetërore. "Në Trust më kanë mbetur para të mia edhe për një vit e gjysmë. Nëse Trepça nuk e rimbursion pjesën tjetër, nuk e di çka të them... nuk e di se si do të jetoj me 214 euro në muaj", thotë Kurti. Qindra minatorë, ndërkohë, kanë ngritur padi civile në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Në mesin e tyre edhe kryetari i Sindikatës, Ibrahim Januzi, por, sipas tij, vendimi i shkallës së parë ka qenë në favor të ndërmarrjes. Radio Evropa e Lirë kërkoi përgjigje nga kjo gjykatë lidhur me rastet e iniciuara nga minatorët dhe vendimet e marra në këto procese, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje.

Një borxh milionësh pa afat për shlyerje

Menaxhmenti i Trepçës thotë për Radion Evropa e Lirë se pagesat në Trust nuk janë bërë kryesisht

që nga viti 2022, por nuk sqaron arsyet. "Vlera e borxhit është rreth gjashtë milionë euro, përfshirë interesin", thuhet në përgjigjen e dërguar me shkrim. Aty nuk jepet as edhe ndonjë afat i mundshëm për shlyerjen e këtij borxhi.

Qeveria e Kosovës - që zotëron 80 për qind të aksioneve në Trepçë, ndërsa 20 për qind u takojnë punëtorëve - nuk iu përgjigj interesimit të Radion Evropa e Lirë për këtë çështje.

Në përgjigjen e Administratës Tatimore të Kosovës thuhet se janë ndërmarrë disa masa ligjore për inkasimin e borxhit, përfshirë gjoba dhe ndalim të shitjes së pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, por se është shmangur bllokimi i llogarive për të mos rrezikuar funksionimin e ndërmarrjes. "Është vlerësuar se një masë e tillë do të pengonte zhvillimin e aktivitetit të ndërmarrjes dhe do të mund të shkaktonte pasoja sociale, përfshirë vështirësi në pagesën e pagave të punëtorëve", thuhet në përgjigjen e ATK-së.

Ky institucion nuk sqaron se sa është vlera e borxhit total, duke thënë se "të dhënat e kërkuara janë konfidenciale".

Sipas ish-drejtorit të ATK-së, Ilir Murtezaj, ndërmarrjet publike shpesh janë trajtuar me tolerancë, për shkak të rëndësisë së tyre ekonomike dhe sociale.

Ai thotë se, në rast të vonesës ose mospagesës së detyrimeve, ATK-ja ka të drejtë të ndërmarrë masa ligjore për mbledhjen e borxhit, duke filluar nga shqiptimi i gjobave dhe kamatave deri te bllokimi i llogarive bankare.

"...por, ndërmarrjet publike janë raste më specifike për shkak të numrit të madh të punëtorëve dhe rëndësisë së tyre për funksionimin ekonomik dhe social. Në shumë raste, shteti ka ndërhyrë duke i mbështetur financiarisht këto ndërmarrje për t'i ndihmuar në tejkalimin e problemeve", thotë Murtezaj për Radion Evropa e Lirë.

Në vitin 2024, Qeveria e Kosovës ndau katër milionë euro për mbulimin e pagave të punonjësve të Trepçës.

Por, në gjithë këtë paqartësi institucionale, më të ekspozuarit mbeten vetë minatorët, veçanërisht ata që janë afër pensionimit, si Fehmi Meha.

Pas dekadash në minierë, ai thotë se ka humbur besimin se do të shohë ndonjëherë një pjesë të kursimeve të tij pensionale.

"Nuk është dashur të vijë puna deri këtu", thotë ai, ndërsa shtyn makinën drejt repartit të riparimit.

DEMOKRACI PA LIDERË



Nga Ernesto GALLI
della Loggia

Tashmë është bërë klishe: sot në Europë demokracitë nuk gëzojnë shëndet të mirë dhe niveli i pëlqyeshmërisë së tyre sigurisht nuk është ndër më të lartët (edhe sepse, le ta kujtojmë, ato janë të vetmet regjime popullariteti i të cilave mund të matet pak a shumë përmes atij treguesi të përafërt, por gjithësi domethënëse, që janë rezultatet zgjedhore. Aty ku zgjedhje nuk ka ose janë të rreme, çdo matje e pëlqimit ndaj regjimit politik është në të vërtetë e pamundur). Megjithatë, gjërat këtu në Europë janë siç thashë: demokracitë nuk pëlqehen. Në sytë e qytetarëve të tyre, demokracitë duken si regjime "të ftohta", që nuk kanë asnjë aftësi për përfshirje emocionale, nuk zgjojnë asnjë ndjenjë të vërtetë identifikimi dhe, për rrjedhojë, as pjesëmarrjeje.

Por arsyeja nuk qëndron vetëm te vështirësitë konkrete, sidomos ekonomike, të cilat gjithësi

ekzistojnë, në të cilat përplasen shoqëritë demokratike, dhe që po e kanë gjithnjë e më të vështirë të mbajnë premtimet e tyre për mirëqenie dhe barazi.

Në të vërtetë, kriza aktuale e demokracisë europiane ka edhe shpjegime krejtësisht të tjera: për shembull, fakti që në regjimet tona demokratike tashmë është zhdukur çdo element vërtet agonistik i politikës. Ka ndodhur, pra, një sterilizim rrënjësor i çdo aspekti të përplasjes, të kundërvënies, dhe për pasojë është zhdukur ajo aftësi që demokracia, si çdo regjim politik, duhet ta ketë për të prodhuar një vetëpërfaqësim publik.

Për shembull, të pushtetit të saj, të një natyre qoftë edhe skenike-spektakolare, por gjithmonë të bazuar përfundimisht mbi konfliktin. Një vetëpërfaqësim natyrisht i përshtatshëm me natyrën e një regjimi politik të ndryshëm nga të gjithë të tjerët, siç është në fakt ai, por gjithësi një regjim politik i destinuar të qeverisë farën e keqe të Adamit, dhe jo një meshë e kënduar.

Është e vërtetë, pra, se

demokracia ka me të drejtë si arritje historike faktin që është ai regjim i cili nuk pret koka, por i numëron ato. Megjithatë, spektakli magjepsës dhe i tmerrshëm i gjyotinës duhet zëvendësuar me diçka tjetër: sigurisht jo po aq të përgjakshme, por që të ketë gjithësi një ndikim emocional dhe ta komunikojë atë.

Një nga këto spektakle, me karakter simbolik, por megjithatë domethënëse, me të cilat regjimet demokratike në fillësë përfaqësonin periodikisht veten, në një mënyrë madje brutale, ishte mbrëmja zgjedhore, gjatë së cilës shihej humbja e palës që deri një ditë më parë ishte në qeveri.

Përmbysja e roleve, pushtetari i rrëzuar nga fronti i tij dhe i reduktuar papritur në mosqenie politike, evokonin dhe korrespondonin në një farë mënyre me modele shumë të lashta të folklorit të revoltës dhe hakmarrjes së popullive europiane (si "charivari").

Më konkretisht, dikur fitorja zgjedhore e një kampi mbi një

tjetër nënkuptonte, për shembull, ligje të reja që vendosnin në mënyrë të rëndësishme për përdorimin e burimeve kolektive, zhvendosnin pushtetin, ndryshonin realisht jetën e njerëzve dhe të grupeve shoqërore.


Sot, përkundrazi, nga e gjithë kjo nuk ka mbetur pothuajse asgjë. Të paktën në Europë. Në fakt, rregulli i demokracive është që tashmë të qeverisen nga klasa politiko-parlamentare mediokre, pa ide të mëdha, pa forcë dhe pa personalitet.

Klasa politike që, për më tepër, transmetojnë dukshëm idenë se nuk vlen më shumë se aq dhe se është vetë e ndërjegjshme për këtë. Të dobësuar edhe nga pesha e brishtë gjeopolitike e vendeve të tyre, si edhe nga mediokriteti i tyre burokratik e administrativ, pa asnjë mandat të fortë politik, edhe sepse nuk kanë pas vetes elektorate të bashkuara dhe të motivuara.

Me pak fjalë, ndërsa është gati të ndryshojë në mënyrë dramatike profili demografik i kontinentit

dhe identiteti i tij qytetar-fetar, ndërsa e gjithë trashëgimia humaniste e së kaluarës europiane rrezikon të lihet në vdesë, i përmbytur nga paragjykimi gjithëpërfshirës-demokratik i sistemeve tona të sotme arsimore; ndërsa aleati ynë historik dhe mbrojtësi amerikan ka vendosur të na lërë në fatin tonë; ndërsa po bëhet e qartë mungesa e sistemeve tona satelitore, e burimeve tona energjetike, e zinxhirëve tanë të sigurt të furnizimit; demokracitë e kontinentit të vjetër duket se vazhdojnë të përkunden në një lloj gjumi të ëmbël.

Opinionet tona publike duken ende të interesuara të merren me paragjykimet e vjetra të shekullit të kaluar dhe me përçarjet e përjetshme fraksioniste. Ndërkohë që bota po digjet dhe këto tashmë i afrohen gjithnjë e më shumë shtëpisë sonë, në Itali ende përbëjnë ndoshta shumicën ata për të cilët thjesht mendimi për të ndërtuar një automjet të blinduar është i barabartë me shkatërrimin e një jetimoreje.



Leipzig nis bisedimet për Asllanin

HOFFENHEIM, 8 QERSHOR - Skuadra e Leipzigut edhe zyrtarisht po synon transferimin e sulmuesit Fisnik Asllani gjatë kësaj vere nga Hoffenheimi për ta forcuar repartin ofensiv për sezonin 2026/27. Është bërë

me dje se drejtuesit e Leipzigut ka kohë që janë në negociata me Asllanin dhe së shpejti do t'i bëjnë ofertë zyrtare Hoffenheimit për shërbimet e tij. Asllani ka kontratë me Hoffenheimin deri në vitin 2029 dhe një

klauzolë lirimi prej 30 milionë eurosh, e cila mundëson largimin e tij këtë verë. Pikërisht, kjo klauzolë në kontratën e Asllanin, ka bërë që edhe skuadrat e tjera, si Borussia Dortmund, Bayern Munchen e

Barcelona, ta monitorojnë situatën e sulmuesit të Kosovës. Asllani në sezonin e tij të parë në Bundesligë ka shkëlqyer te skuadra e Hoffenheimit, ku ka shënuar 10 gola dhe ka bërë 9 asistime në 33 paraqitje.



KOSOVA RIKTHEHET TE FITORJA, TRIUMFI NDAJ ANDORRËS IU DEDIKUA FATJON BUNJAKUT

PRISHTINË, 8 QERSHOR - Kombëtarja e Kosovës është rikthyer te fitorja, duke e mposhtur Andorrën me rezultat 3:0 në ndeshjen miqësore të zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kjo ndeshje ishte e mbushur me emocione, pasi para fillimit të takimit është mbajtur një minutë heshtje në nderim të futbollistit Fatjon Bunjakut, i cili ka humbur jetën tragjikisht. Në shenjë respekti për kujtimin e tij, lojtarët e Kosovës ia kanë dedikuar atij golat dhe fitoren e kësaj ndeshjeje. "Dardanët" kanë dominuar që

nga fillimi, duke kontrolluar posedimin e topit dhe ritmin e takimit. Megjithatë, goli i epërsisë ka ardhur në minutën e 41-të kur Fisnik Asllani ka realizuar nga gjuajtja e lirë. Me epërsinë minimale të Kosovës është mbyllur pjesa e parë, derisa në vazhdim skuadra e Franco Fodës e ka vulosur fitoren edhe me dy gola të tjerë. Në minutën e 52-të Albion Rrahmani është treguar i saktë nga pika e bardhë për rezultatin 2:0. Pas golave ai dhe Asllani kanë ngritur fanellën me emrin e Fatjon Bunjakut, duke ia dedikuar realizimet e tyre

futbollistit të ndjerë. Goli i tretë dhe i fundit i takimit ka ardhur në minutën e 77. Valmir Matoshi ka shënuar golin e parë me fanellën e Kosovës, duke realizuar me kokë pas një aksioni të mirë të "Dardanëve". Deri në fund rezultati ka mbetur i pandryshuar dhe Kosova e ka mbyllur me fitore këtë ndeshje miqësore e cila do të mbahet mend jo vetëm për triumfin në fushë, por edhe për nderimin e veçantë kushtuar Fatjon Bunjakut. Për këtë fitore futbollistët e Kosovës dhe tifozët i ka uruar presidenti i FFK-së Agim Ademi.



"Kjo ndeshje solli energji pozitive dhe konfirmoi potencialin e madh të brezit të

ri, me disa prej talenteve tanë që shfaqën cilësi dhe karakter, duke dëshmuar se e ardhmja e Kombëtares së Kosovës është në duar të sigurta. Faleminderit të gjithë tifozëve të pranishëm për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkrahjen që u dhanë futbollistëve dardanë! Urime Dardanëve për paraqitjen dhe fitoren! Vazhdojmë së bashku drejt sfidave të radhës", ka thënë Ademi. Kombëtarja e Kosovës do të rikthehet në aksion në muajin shtator, kur do t'i nisë sfidat në Ligën e Kombeve me ndeshjen kundër Irlandës.

MURIQI, TRANSFERIMI I PARË TE FENERBAHÇE



STAMBOLL, 8 QERSHOR - Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, pritet që shumë shpejt të zyrtarizohet lojtar i ri te skuadra e Fenerbahçes. Zgjedhja e Aziz Yildirim në postin e presidentit të Fenerbahçes ka hapur rrugën për transferimin e Muriqit nga

skuadra e Mallorcas te gjiganti turk. Muriqi ishte "pjesë" e kampanjës së Yildirimit për fitimin e zgjedhjeve te Fenerbahçe dhe pritet të jetë transferimi i parë në periudhën e tij të re në krye të klubit. Mediumet në Turqi dhe Spanjë kanë shkruar se Mallorca do të

përfitojë rreth 16 milionë euro nga shitja e Muriqit, i cili me klubin spanjoll ka kontratë deri në vitin 2029. Muriqi ka shkëlqyer në sezonin e fundit në kampionatin spanjoll, ku shënoi 23 gola, por rënia e Mallorcas nga La Liga ka bërë që sulmuesi nga Kosova të

kërkojë sfidë të re. Transferimi i Muriqit te Fenerbahçe mund të zyrtarizohet shumë shpejt, pasi marrëveshja edhe është arritur mes palëve, ku "Pirati" do të firmosë kontratë deri në vitin 2028, me opsionin e vazhdimin edhe për një vit tjetër.

FEYENOORDI SHKARKON ROBIN VAN PERSIEN PAVARËSISHT PREJ KUALIFIKIMIT NË LIGËN E KAMPIONËVE

ROTTERDAM, 8 QERSHOR - Fund i papritur i aventurës së Robin van Persien në stolin e Feyenoordit. Klubi holandez ka konfirmuar shkarkimin e legjendës së futbollit holandez vetëm pas një sezoni të plotë në krye të skuadrës pavarësisht se e udhëhoqi ekipin drejt vendit të dytë në Eredivisie dhe kualifikimit për edicionin e ardhshëm të Ligës së

Kampionëve. Ish-sulmuesi i Arsenalit, Manchester Unitedit dhe Kombëtares së Holandës kishte kontratë deri në verën e vitit 2027, por drejtuesit e rinj të klubit ka vendosur ta ndërpresin bashkëpunimin pas një analize të brendshme të sezonit. Sipas drejtorit teknik Devy Rigaux, vendimi është marrë duke marrë parasysh rënien e rezultateve dhe

zhvillimin e stilit të lojës si në kampionat ashtu edhe në garat evropiane. Van Persie e ka mbyllur sezonin në vendin e dytë, por Feyenoordi ka mbetur 19 pikë prapa kampionit PSV Eindhoven dhe ka pasur periudha të gjata me rezultate të dobëta. Kritikkat ndaj trajnerit 42-vjeçar janë shtuar gjatë muajve të fundit për shkak të paraqitjeve të paqëndrueshme

dhe tensioneve të raportuara me disa futbollistë të skuadrës. Holandezi ka marrë drejtimin e Feyenoordit në shkurt të vitit 2025 dhe gjatë mandatit të tij drejtoi ekipin në 58 ndeshje zyrtare. Kështu, një tjetër emër i madh i futbollit evropian largohet nga pankina më shpejt sesa pritej, ndërsa Van Persie duhet ta presë sfidën e radhës në karrierën si trajner.



Xhaka kritikon performancën e dobët të Zvicrës

BERNË, 8 QERSHOR - Kapitani Granit Xhaka ka paralajmëruar Kombëtaren e Zvicrës në prag të nisjes së Kampionatit Botëror. Xhaka ka kritikuar publikisht performancën e dobët të Zvicrës në barazimin 1:1 ndaj

Australisë, ndeshje kjo që ishte testi i fundit para Botërorit. Ky barazim me Australinë vjen pas humbjes 2:0 që Zvicra e kishte pësuar nga Gana, po ashtu në ndeshjen kontrolluese në prag të Kupës së Botës. "Kishte

gjëra që nuk ishin mirë javën e fundit dhe kjo ndikoi edhe në lojën tonë. Nuk mund të luajmë kështu, përndryshe do të shkojmë në shtëpi pas tri ndeshjeve. Duhet të zgjohemi tani dhe kemi një javë për t'u bërë gati", ka thënë Xhaka.

Zvicra është pjesë e Grupit B në Botërorin që nis pas tri ditësh, ku do të përballet me Katarin, Bosnjë-Hercegovinën dhe Kanadanë. Ndeshjen e parë në Botëror, Zvicra e luan të shtunën në mbrëmje kundër Katarit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit Kombëtare (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 05/2026), lidhur me nenin 29.2 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2026 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.894 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Auditor junior për auditim financiar dhe pajtueshmëri
Numri i referencës:	RAJAFP/ZKA/06-04/26
Grada:	ZKA-Z4
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon UE në mbledhjen e informatave paraprake për auditimet ku angazhohet, për përgatitjen e dosjeve të auditimit dhe punë tjera në lidhje me auditimin;
- Shkrimi i letrave të punës së auditimit të qarta për çështjet e trajtuara dhe sipas standardeve të ZKA-së dhe të njëjtat i dorëzon me kohë të UE;
- Indeksimi i letrave të punës për temat (mostrat) dhe fushat e audituara dhe të gjitha dokumentet (edhe ato që merren në Entitete) duhet të jenë në pajtueshmëri më formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga metodologjia, që t'i mundësoj UE një rishikim me të lehtë;
- Përfundimi me kohë i letrave të punës, memove të komponentëve dhe të gjitha detyrave sipas kërkesave të UE për t'i arritur planet kohore të aprovuar nga menaxhmenti;
- Ofron bashkëpunim dhe informata të sakta për Ekipin e auditimit, departamentin e tij dhe me të gjithë sektorët dhe departamentet e tjerë në kuadër të ZKA-së;
- Ndihmon stafin tjetër të ekipit dhe të departamentit, rreth punëve audituese, për përdorim të teknologjisë informative, ofron përkrahje UE dhe të jetë përgjegjës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të ekipit dhe të departamentit;
- Komunikim të mirë me anëtarët e ekipit me UE, DD, stafin e ZKA dhe me stafin e entiteteve gjatë auditimit;
- Të ruajë dhe azhurnoi njohuritë profesionale dhe teknike dhe të tregojë gatishmëri për të marrë njohuri të reja nga fusha e auditimit për fushat e dakorduara me UE dhe DD gjatë vlerësimit të performancës për vitin e kaluar, dhe të ndjekë trajnimet e organizuara nga ZKA që lidhen me Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Tregon integritet të lartë dhe vepron në pajtim me Kodin Etik dhe të Mirësjelljes Profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë ZKA-së;
- Kryen edhe detyra tjera profesionale që mund të kërkohen nga UE dhe DD i/e tij.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomik, juridik, administratë publike, matematikë financiare në banka dhe sigurime ose Inxhinierisë;
- Përvoja profesionale: Dy (2) vite përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa ose administratë;
- Certifikimi: Të ketë certifikatë si teknik kontabilitetit, asistent-auditor i sektorit publik ose auditor i brendshëm.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri në fushën e auditimeve;
- Shkathësi në organizim të punës dhe përbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëprehet kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- certifikatë për teknik kontabiliteti, asistent-auditor i sektorit publik ose auditim i brendshëm;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **24.06.2026 ora: 16:00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjena i dopunjena Uredbom (NKR) Br. 05/2026), u vezi sa članom 29.2 Pravilnika (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjim planom zapošljavanja za 2026. godinu i Odlukom generalne revizorke br. 894 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije ponovo objavljuje:

KONKURS

za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Junior revizor za finansijsku reviziju i reviziju usklađenosti
Referentni broj:	RAJAFP/ZKA/06-04/26
Rang:	ZKA-Z4
Broj pozicija:	Jedan (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže VT-u u prikupljanju preliminarnih informacija za revizije u kojima je angazovana, u pripremi revizorskih dosijea i drugim poslovima vezanim za reviziju;
- Pisanje revizorskih radnih dokumenata o obrađenim pitanjima i u skladu sa standardima NKR-a i iste blagovremeno dostavlja VT-u;
- Indeksiranje radnih dokumenata za revidirane teme (uzorke) i oblasti i svi dokumenti (i one dobijene od entiteta) moraju biti u skladu sa formatom i zahtevima utvrđenim u metodologiji, kako bi se omogućio lakši pregled od strane VT-a;
- Blagovremen završetak radnih dokumenata, memoranduma o komponentama i svih zadataka u skladu sa zahtevima VT-a kako bi se postigli rokovi koje je odobrilo rukovodstvo;
- Pruža saradnju i tačne informacije revizorskom timu, njegovom odeljenju i svim ostalim sektorima i odeljenjima u okviru NKR-a;
- Pomaže ostalom osoblju tima i odeljenja u revizorskom radu, koristeći informacione tehnologije, pruža podršku VT-u i odgovoran je za obavljanje dužnosti radi postizanja ciljeva tima i odeljenja;
- Dobra komunikacija sa članovima tima, sa VT-om, DO-om, osobljem NKR-a i osobljem entiteta tokom revizije;
- Održava i ažurira stručno i tehničko znanje i pokazati spremnost za sticanje novih znanja iz oblasti revizije za oblasti dogovorene sa VT-om i DO-om tokom procene učinka za prethodnu godinu, i pohađati obuke koje organizuje NKR koje se odnose na kontinuirano stručno usavršavanje;
- Pokazuje visok integritet i postupa u skladu sa Etičkim kodeksom i profesionalnog ponašanja, kako unutar tako i van NKR-a;
- Obavlja i druge profesionalne zadatke koje mogu zahtevati VT i DO.

Opšti formalni zahtevi za ovu poziciju, u finansijskim i revizijama i revizijama usklađenosti, su:

- Obrazovanje: Univerzitetska diploma ekonomije, prava, javne uprave, finansijske matematike u bankarstvu i osiguranju ili inženjerstva;
- Profesionalno iskustvo: Dve (2) godine stručnog radnog iskustva u reviziji, računovodstvu, finansijska ili administraciji;
- Sertifikacija: Posedovati sertifikat za računovodstvenog tehničara, pomoćnika revizora javnog sektora ili internog revizora.

Potrebne veštine:

- Znanje iz oblasti revizije;
- Veštine u organizovanju posla i ispunjavanju ciljeva;
- Poznavanje pravnih akata koji se primenjuju na Nacionalnu kancelariju revizije;
- Poznavanje efikasnog nadzora profesionalnog rada;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikacijske sposobnosti u timu;
- Posedovati dobre međuljudske sposobnosti.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonskim propisima.

Postupak prijave:

Postupak prijavljivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju da dostave potrebnu dokumentaciju, kao nadole:

- službeni obrazac za prijavu NKR-a;
- kopija lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- sertifikat za računovodstvenog tehničara, pomoćnika revizora javnog sektora ili internu reviziju;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa položaja javnog službenika (ako je primenljivo);

Samo službeni obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti podneti nakon roka neće biti razmatrani, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **24.06.2026, u 16:00 casova**.

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostaviti Odeljenju za upravljanje dokumentima na adresu: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o pošiljci dostavljeno poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

